

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.


Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimin të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Korrik, 2023

Autoritetet antikorrupsion nisin hartimin e Pozicionit Negociues për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian

03 - 25.07.2023: Procesi i integritetit ka hyrë gradualisht në një fazë impenjative për administratën shqiptare. Pas zhvillimeve të takimeve teknike *screening* me struktura të Komisionit Evropian, kapitujt që tashmë kanë mbyllur këtë fazë, kanë nisur me përgatitjen e dokumentit që do të jetë Pozicioni Negociues i Shqipërisë. Fusha e antikorrupsionit si pjesë e kapitullit 23: Liria, drejtësia dhe funksionimi i institucioneve demokratike pritet të jetë i orientuar drejt parashikimeve për përpunshmërinë e plotë të politikave dhe legjislacionit kombëtar të fushës me *acquis* të Bashkimit Evropian, përafrimin e kuadrit institucional dhe të kapaciteteve administrative me *acquis* si edhe masa dhe aktivitete të parashikuara për të arritur përpunshmërinë e plotë. Stafet teknike të fushës antikorrupsion me funksione parandalimi si Ministria e Drejtësisë me Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion, ILDKPKI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Agjencia e Prokurimit Publik, AKSHI, etj., janë duke konceptuar këto masa veprimi mbështetur në afate konkrete. Edhe organet ligjzbatuese Prokuroria e Përgjithshme e SPAK gjithashtu edhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit kanë hyrë në këtë proces duke programuar ndërhyrjet e tyre. Dokumenti i Pozicionit Negociues të shoqëruar nga planet e veprimit do të jenë pasaporta e Shqipërisë që do të garantojë anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian dhe që do të mbështetet në Agjendën e Shqipërisë 2030. Masat konkrete të programimit të vendit për në Bashkimin Evropian do të startojnë me miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023 - 2030, e cila do të jetë një ndërthurje e politikave parandaluese - ndëshkuese - ndërgjegjësuere kundër korrupsionit.



Nis hartimi i raportit i monitorimit të zbatimit të Planit të Veprimit Antikorrupsion, janar - qershor 2023



20.07.2023: Drejtoria e Programeve dhe Projekteve Antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë ka përgatitur draftin e raportit të monitorimit për periudhën janar-qershor 2023 të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2015-2023. Drafti i parë i monitorimit ofron një analizë dhe vlerësim të 18 objektivave specifike që përfshijnë tre qasje politikash: parandalim, ndëshkim dhe ndërgjegjësim kundër korrupsionit. Në këtë raport, prezantohet një vlerësim 6-mujor i performancës, duke reflektuar të dhënat mbi zbatimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara. Rezultatet e paraqitura tregojnë se treguesit e performancës kanë shënuar arritje të larta gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023: 222 autoritete publike kanë instaluar regjistrin elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve; Agjencia e Prokurimit Publik vijon të mbajë nën nivelin e përcaktuar elementët e ndryshuar të kontratave publike; AKSHI regjistron 2.827.371 përdorues në platformën E-Albania, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion vijnë një bashkëpunim të frytshëm, si pasojë e të cilit janë trajtuar 202 ankesa, janë dhënë 83 masa për fillimin e ecurisë disiplinore, 29 masa për largim nga detyra, 109 rekomandime dhe 9 referime penale, me 28 persona të kallëzuar; Policia e Shtetit ka evidentuar 443 vepra penale, me 510 autorë, me një nivel zbulueshmërie në masën 84.19%, etj. Në vijim, draft raporti po rishikohet nga institucionet publike, të cilat do të plotësojnë dhe pasurojnë analizën të kërkuar, e më tej, raporti do të diskutohet dhe dakordësohet në nivel teknik në mbledhjen e pikave të kontaktit antikorrupsion.

Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion jep masa dhe detyra për organet e administratës publike

03 - 31.07.2023: Gjatë muajit korrik 2023, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë ka kryer hetime administrative në shumë institucione, përfshirë Rrjetin e Koordinatorëve Antikorrupsion, duke reaguuar ndaj ankesave dhe denoncimeve të marra nga burime të ndryshme. Rastet i adresohen kryesisht Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Postës Shqiptare apo Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Pas një verifikimi të hollësishëm administrativ, janë hartuar 4 raporte përfundimtare duke ndërmarrë masa disiplinore ndaj personave të identifikuar në shkelje. Këto hetime administrative kanë për qëllim zbatimin e ligjit dhe përmirësimin e praktikave të institucioneve të prekura, teksa Rrjeti i Koordinatorëve Kundër Korrupsionit vijon punën me hetimet e rasteve të denoncuar me synim intensifikimin e luftës kundër korrupsionit në të gjitha institucionet, pjesë përbërëse e tij. Në terma konkretë, gjatë këtij muaji, në adresën e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit janë depozituar 27 ankesa, pas shqyrtimit të kujdesshëm të të cilave, është konkluduar me 3 masa për fillimin e ecurisë disiplinore, 2 referime në organet e zbatimit të ligjit si dhe 9 rekomandime për institucionet publike. Përdorimi i hetimeve administrative dhe rekomandimeve të përfunduara, ndihmon në forcimin e strukturave institucionale dhe kultivimin e kulturës së transparencës në institucionet publike. Punë e vazhdueshme në këtë drejtim do të ndihmojë në përmirësimin e klimës së integritetit dhe në përdorimin e burimeve njerëzore në mënyrë efektive.



Denonconi raste dhe praktika abuzive në: koordinatoriak@drejtesia.gov.al

Udhëzuesi për hetimet e shpejta për rikuperimin e aseteve, një instrument i shtuar pune për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore

GUIDE ON FAST REACTION ON FINANCIAL INVESTIGATION, SEIZURE, CONFISCATION AND RECOVERY OF CRIMINAL ASSETS

1. INTRODUCTION 2
1.1 PURPOSE OF THE FAST REACTION GUIDELINE 2
2. LEGAL FRAMEWORK 3
2.1 National Procedures and Legislation 3
2.2 Bilateral Agreements 3
2.3 International Treaties and Conventions 3

TË DHËNËT PËR REAGIM TË SHPEJTË NË HETIMET FINANCIARE, SEIZURE, KONFISKIMIN DHE RIKUPERIMIN E ASETEVE PENALE
1. HYRE 2
1.1 QËLLIMI I KËRKIMIT PËR REAGIM TË SHPEJTË 2
2. KADRE JURIDIK 3
2.1 Ligjetshëria Kombëtare 3
2.2 Marrëveshjet Bilaterale 3
2.3 Traktatet Ndërkombëtare dhe Konventat 3

03 - 31.07.2023: Një dokument udhëzues për hetimin e krimeve financiare dhe ekonomike, për oficerët e policisë gjyqësore pranë prokurorive dhe të policisë si dhe prokurorët, po përgatitet nga një grup profesionistësh ministri-prokurori-policia-pastrimi i parave. Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit po zbaton një projekt të UNODC me qëllim hartimin e Udhëzuesit për Reagim të Shpejtë për rikuperimin e aseteve, në Shqipëri. Udhëzuesi synon që t'u ofrojë oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve një kuadër standard të aspekteve ligjore dhe të veprimeve që duhen pasur parasysh në fazën e verifikimeve paraprake ose gjurmimit policor, gjatë referimit të veprës penale ose referimit pasuror në Prokurori. Udhëzuesi mund të lehtësojë procesin e kryer në fazën e hetimeve paraprake për mbledhjen e provave, fakteve dhe dokumenteve si edhe për kërkimin dhe gjetjen e pasurive të krijuara nga burime kriminale, në fazën e sekuestrimit me qëllim përfundimtar konfiskimin e pronës. Udhëzuesi synon mbështetjen në nivel operacional të ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve profesionale mbi elementët e ndryshëm të procesit të rikuperimit të aseteve. UNODC po asiston vendet e Ballkanit Perëndimor me hartimin e këtij dokumenti tip, përpunueshmërisht me kuadrin ligjor dhe rregullator të çdo vendi.

Rrjeti GlobE, një mekanizëm që bashkon profesionistët e politikave dhe zbatimit të ligjit antikorrupsion

11 - 14.07.2023: Rrjeti GlobE zhvilloi punimet e seancës së 4-t plenare. Shqipëria përfaqësohet në këtë organizëm nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, Prokuroria e Përgjithshme dhe SPAK. Shkëmbimi i informacionit midis anëtarëve të Rrjetit, përdorimi i mjeteve të zhvilluara të komunikimit në luftë kundër korrupsionit (*Threema channel*), biseda dhe takime dy-palëshe dhe shumë-palëshe midis anëtarëve shoqëruan këtë plenare. Autoritetet pjesëmarrëse të vendeve anëtare në GlobE forcojnë njohuritë profesionale të fushës, risitë dhe kapacitetet e njësisë antikorrupsion dhe të organeve ligjzbatuese duke shkëmbyer eksperiencat dhe praktikat më të mira. Ngritja dhe zhvillimi i një kanali me një ndalesë (*one-stop*) për të lehtësuar të dhënat dhe informacionet dhe ngritur programe zhvillimi, ishin gjithashtu tematikë e ditëve të takimit. Shqipëria iu bashkua Rrjetit GlobE-Rrjeti Botëror Operacional i Autoriteteve Ligjzbatuese Antikorrupsion, prej vitit 2021 në cilësinë e anëtarit.



Lufta kundër korrupsionit në fushën e prokurimeve publike; trajnim dhe ndarje ekspertize në Shkollën e Magjistraturës



13.07.2023: Gjatë këtij muaji, Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion dhe Rrjeti i Koordinatorëve Antikorrupsion kanë marrë pjesë në një trajnim të specializuar pranë Shkollës së Magjistraturës me temë "Praktika gjyqësore për prokurimin publik". Trajnimi u zhvillua në bashkëpunim me Institutin Evropian të Administratës Publike EIPA dhe synonte të nxiste përpjekjet dhe kapacitetet profesionale për të siguruar hetime të plota administrative. Pjesëmarrësit, stafi teknik dhe koordinatorët antikorrupsion morën njohuri të reja mbi rregullat dhe praktikën e Prokurimit Publik Evropian, si dhe praktikën gjyqësore të zbatuara në Shqipëri dhe Bashkimin Evropian në lidhje me këtë fushë. Pjesëmarrësit u pajisën me informacione të shtuara veçanërisht në çështjet e mashtrimit dhe korrupsionit në prokurim publik, duke ndjekur metodologjinë të praktikës gjyqësore për zbatimin e ligjeve e praktikave konkrete. Rastet praktike dhe ushtrimet e përdorura në këtë trajnim ndihmuan pjesëmarrësit të kuptonin sfidat dhe mënyrat e efikasë për të luftuar korrupsionin në fushën e prokurimit publik. Kjo përvojë do të shërbejë si një burim i vlefshëm i njohurive për përmirësimin e përgjigjes institucionale ndaj çështjeve të korrupsionit dhe mashtrimit në prokurimin publik, si dhe për forcimin e strukturave publike në mirëadministrimin, kontrollin dhe menaxhimin e aseteve publike. Njohuritë e fituara ndihmojnë më tej në avancimin e luftës kundër korrupsionit dhe në përmirësimin e integritetit të prokurimit publik në vend. Ky zhvillim pozitiv do të kontibutojë gjithashtu në forcimin e partneritetit të Drejtorisë së Përgjithshme Antikorrupsion me institucione të tjera në fushën e luftës kundër korrupsionit e demonstrojë angazhimin e palëve për përmirësimin e përgjigjes ndaj sfidave të kësaj natyre.



Zyrtarë të legjislacionit marrin pjesë në shkollën verore të RAI, në Sarajevë në Bosnje dhe Hercegovinë

03 - 07.07.2023: Në kuadër të edicionit të tetëmbëdhjetë me temën "Profesionistët e rinj për Anti-Korrupsionin nga Evropa Juglindore", profesionistët e fushave të ndryshme nga vendet e Ballkanit dhe vende anëtare të RAI morën pjesë në një aktivitet organizuar nga Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit RAI, në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë. Në këtë aktivitet, u trajtuan tema të ndryshme rreth konstatimit, hetimit dhe parandalimit të veprimeve korruptive, duke përqëndruar vëmendjen në analizimin e rrisqeve në të gjitha nivelet. Ekspertët prezantuan dy mekanizma të rëndësishëm për identifikimin e rreziqeve të korrupsionit, përkatësisht: Vlerësimin e Riskut të Korrupsionit (CRA) dhe Verifikimin e Legjislacionit Kundër Korrupsionit (CPL). Pjesëmarrësit në aktivitet morën pjesë në ushtrime dhe analiza për të praktikuar zbatimin e këtyre dy mekanizmave vlerësimi, ndërsa ndanë njohuri dhe përvoja nga vendet e tyre për të luftuar korrupsionin. Kjo shkollë verore ofroi një platformë efektive për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave të mira, duke e fuqizuar bashkëpunimin ndërmjet profesionistëve të rinj kundër korrupsionit në vendet e Evropës Jug-Lindore. Në përfundim të aktivitetit, pjesëmarrësit u testuan dhe u certifikuan me sukses, në zbatimin e informacionit të marrë mbi njohuritë e shtuara në këto fusha të vlerësimit të legjislacionit.

